

Karta e Pacientit për Valproatin (Convulex)

Çfarë duhet të dini dhe të bëni

Për të gjitha vajzat dhe gratë që përdorin valproat dhe që mund të mbeten shtatzënë:

- Valproati mund të shkaktojë dëmtime serioze te fëmija i palindur kur merret nga nëna gjatë shtatzënisë.
- Përdorni gjithmonë një metodë efektive kontraceptive, pa ndërprerje, gjatë gjithë periudhës së trajtimit me valproat.
- Nëse mendoni se mund të jeni shtatzënë: caktoni menjëherë një takim urgjent me mjekun tuaj.
- Vizitoni mjekun specialist të paktën një herë në vit.

Për meshkujt që përdorin valproat:

- Ekziston një rrezik i mundshëm për çrregullime të zhvillimit motorik dhe mendor te fëmijët kur valproati merret nga babai gjatë 3 muajve para konceptimit.
- Diskutoni me mjekun tuaj për këtë rrezik të mundshëm dhe për nevojën e përdorimit të një metode efektive kontraceptive.

----- Ana tjetër -----

Karta e Pacientit për Valproatin (Convulex)

Çfarë duhet të dini dhe të bëni

Valproati është një bar efektiv për trajtimin e epilepsisë, çrregullimit bipolar dhe migrenës.

Kjo vlen për të gjitha vajzat dhe gratë që përdorin valproat dhe që mund të mbeten shtatzënë, si dhe për meshkujt që përdorin valproat:

Lexoni me kujdes fletëudhëzuesin e paketimit përpara përdorimit.

- Mos e ndërprisni kurrë marrjen e valproatit, përveç nëse mjeku juaj ju udhëzon ta bëni këtë, pasi gjendja juaj mund të përkeqësohet
- Nëse po planifikoni të keni një fëmijë, mos e ndërprisni përdorimin e valproatit dhe as kontracepsionin përpara se të konsultoheni me mjekun tuaj.
- Kërkoni nga mjekut juaj t'ju japë Udhëzuesin për Pacientin.

Ruajeni këtë kartë në një vend të sigurt, në mënyrë që të dini gjithmonë se çfarë duhet të bëni.



